



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:246611
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626441

Cap.nr.1836/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit F.M. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B., avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike përmbartimore-pagesë e pagave jubilarë, shujtës dhe udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, CPK.nr.21/23 të datës 15.11.2023, jashtë seance me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, CPK.nr.21/23 i datës 15.11.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar CPK.nr.21/23 të datës 15.11.2023, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, i datës 21.09.2023, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.1344/23 të datës 28.09.2023. Në pikën dy, ka mbetur në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.1344/23 i datës 28.09.2023, i përmbartuesit privat Blerim (Gëzim) Baloku nga Peja. Në pikën tre, obligohet debitori-Komuna e Novobërdës, që në emër të shpenzimeve të procedurës së përmbartimit të paguaj shumën prej 117.00 euro, për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të pezullohet ekzekutimi dhe të gjitha veprimet përmbartimore të zbatuara të anulohen.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori përmes të autorizuarës së tij, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.590/20 të datës 25.03.2021, i plotfuqishëm nga data 20.03.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 14.04.2023. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar nga kreditori me urdhrin P.nr.1344/23 të datës 28.09.2023, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 12.10.2023, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 20.10.2023. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit përmbartues, organi përmbartues e cakton përmbartimin vetëm në bazë të titullit përmbartues sipas dispozitë së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, si dokument përmbartues është: *“vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese”*. Në rastin konkret titull përmbartues është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.590/20 të datës 25.03.2021, i plotfuqishëm nga data 20.03.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 14.04.2023. Dokument përmbartues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së është përcaktuar se: *“vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdë gjyqësore konsiderohet ujdë e arritur para gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimin”,* dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me aktgjykim siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye

të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.1836/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti